



Quhet Kejdi Bare dhe eshte 17 vjec. Kapiteni i kombetares shqiptare te moshes se tij, mesfushori fantasist ka nisur nje prove disa ditore tek skuadra e Atletico Madrid. Tek moshataret e tij ai po ben gjera mjaft te mira dhe sic tregojne burime prane tij, Bare i ka bere te gjitha per vete, madje edhe drejtuesit e skuadres se pare qe e kane ndjekur gjate nje ndeshje miqesore. Mesfushori eshte ne fokusin e De Biazit qe e ka pare me 17-vjecaret dhe e ka pelqyer shume. Bare eshte nje nga futbollistet me premtues qe Shqiperia po ben gati dhe aventura e tij tek Atletico e Madrid nuk eshte nje rastesi.